



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201501445/2

Tiranë ____/____/2015

Lënda: Rekomandohet *"Marrja e masave të menjëhershme për trajtimin mjekësor të të paraburgosurit M. Gj., nga Shkodra"*

Drejtuar : **Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale**
 "Shënkoll"
 Z. Kanto NDOI

LEZHË

I nderuar Z.NDOI,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit më datë 28.07.2015, ka paraqitur ankesë shtetasi Gj. Gj., nga Shkodra, i cili ka ngritur shqetësimin se nga personeli i shërbimit mjekësor në IEVP "Shënkoll" Lezhë, djalit të tij të paraburgosur M. Gj., i është mohuar e drejta e shërbimit shëndetësor, pas ushtrimit të dhunës nga punonjësit e policisë Shkodër, gjatë arrestimit të tij.

Në nenin 5 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve" i ndryshuar, i cili bën fjalë për Parimet Themelore, thuhet: *"Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre"*.

Kurse në nenin 33 të ligjit të mësipërm, i ndryshuar, i cili bën fjalë për Shërbimin Mjekësor, thuhet: *"Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve"*.

"Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë".

Të drejtat e të dënuarve për trajtim në shërbimin shëndetësor parashikohen dhe në aktet ndërkombëtare. Kështu, në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Europës datë 12 Shkurt 1987 "Për Rregullat

Europiane të Burgut”, ku në kapitullin që bën fjalë për Drejtimin e Sistemit të Burgjeve, Pikën 30.1 thuhet: *“Mjeku do të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të burgosurve dhe në përputhje me kushtet e intervalet e standarteve spitalore, do të vizitojë të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që raportojnë për sëmundje, ose dëmtim dhe çdo të burgosuri t’i kushtohet një vëmendje e veçantë”.*

Kurse në Pikën 32 thuhet: *“Shërbimet mjekësore të institucionit do të kërkojnë që të diagnostikojnë e kurojnë çdo sëmundje ose të metë fizike e mendore, që mund të pengojë riinjetgrimin e një të burgosuri pas lirit. Për këtë qëllim, të burgosurit do t’i sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore , krirugjikale dhe psihiatrike , përfshirë ato që janë në dispozicion të komunitetit”.*

Për sa sipër duke gjetur se ankesa e shtetasit Gj. Gj., është e drejtë, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOHE T

“Marrja e masave të menjëhershme për trajtim mjekësor të të paraburgosurit M. Gj., nga Shkodra”

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI

